

Ditari Naturës



Nr. 45 Viti i pestë i botimit Shkurt 2017

Në këtë numër do të gjeni:

- ...me këtë rast Ju kujtojmë se...
- Promovohet marka "Pelikani Miqsor"
- Natyra për të ardhmen - bashkëpunim i fuqishëm për zonat e mbrojtura
- Ftesë drejtuar gazetarëve që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në qytetet Shkodër, Tiranë, Elbasan, Berat dhe Vlorë / nga Qendra EDEN
- Njoftime


... me këtë rast Ju kujtojmë se
57 vjet më parë ...

...Ekonomia pyjore e Dajtit, në rrethin e Tiranës, me sipërfaqe 3,028.7 ha, u shpall "Park Kombëtar", me vendim të Këshillit të Ministrave nr.93, datë 16.02.1960. Njëherazi përfaqëson edhe Parkun e parë Kombëtar të Shqipërisë.

Në kuadër të studimit për krijimin e Rrjetit të Parqeve Kombëtar të Shqipërisë, me vendim të Këshillit të Ministrave nr.96, datë 21.11.1966, sipërfaqja e Parkut Kombëtar të Dajtit u zgjeruar me 3,300.0 ha.

Më pas, bazuar në dispozitat e Ligjit nr.8906, datë 06.06.2002, "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, ekosistemi natyror i

Vijon në faqe 2



Parku Kombëtar i Dajtit © Foto INCA

Organizatrat partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



Vijon nga faqe 1

Mali i Dajtit”, me sipërfaqe 29,384.18 ha, i shtrirë në Qarkun e Tiranës dhe të Durrësit, me VKM nr.402, datë 21.06.2006, u rishpall “Park Kombëtar” me sipërfaqe të zgjeruar.

Më pas me VKM nr. 715, datë 23.06.2009, bazuar në studimin e kryer se në këto territore gjenden edhe komponente mineralogjike të tokave të rralla si Vanadium, Galium, Germanium, Selen, etj, sipërfaqja e parkut kombëtar u zvogëluanë 29,216.89 ha.

Brenda kësaj sipërfaqe u përfshi dhe Rezervati Natyror i Menaxhuar (ish rezervati i gjuetisë) “Qafë Mollë-Derje” me sipërfaqe 3,458.0ha, miratuar me rregulloren e Ministrisë së Bujqësisë nr.1, datë 27.07.1977. Me urdherin nr.404, date 25.1.1983 “Mbi caktimin e rezervateve të gjuetisë”, sipërfaqja u ul në 3,300 ha...

... 18 vjet më parë ...

...Territori natyror i zonës së Prespës së Madhe dhe i Prespës së Vogël, me sipërfaqe të përgjithshme 27,750.0 ha, me VKM nr.80, datë 18.02.1999, shpallet “Park Kombëtar”, përfshihet në qarkun e Korçës dhe në rrethet Korçë dhe Devoll. Brenda këtij territori është përfshirë (duke ndërruar dhe statusin) edhe sipërfaqja e ish rezervatit të gjuetisë “Gorricë”, me sipërfaqe 18,150.0 ha, miratur me urdhër të ish Ministrisë së Bujqësisë, në vitin 1957.

Pjesë e territorit të Parkut Kombëtar “Prespa”, gëzon edhe statusin e Zonës RAMSAR, sipas VKM nr.489, datë 13.06.2013, me sipërfaqe 15,118.6 ha.

Me VKM nr. 80, datë 18.02.1999, territori natyror i pellgut ujëmbledhës të Liqenit të Ohrit, me sipërfaqe të përgjithshme 27,323.0 ha, shpallet Peizazh i Mbrojtur tokësor/ujor”, përfshihet në qarkun e Korçës dhe rrethin e Pogradecit...

...12 vjet më parë ...

..me VKM nr.86, datë 11.02.2005 për “Krijimin e komiteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura”, në zbatim të pikës 2 të nenit 17 të ligjit nr.8906, datë 06.06.20002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar...

...4 vjet më parë ...

...VKM nr. 221, datë 20.02.2013 “Për caktimin e zonave të brezit të gjelbër të qytetit të Tiranës dhe të rrethinave të tij”, në mbështetje të neneve 3, 20/3 dhe 23 të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2001 “Për mbrojtjen mjedisit”, të ndryshuar dhe pikës 4, të nenit 27 të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar...

...4 vjet më parë ...

...VKM nr.134, datë 20.02.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.693, datë 10.11.2005, të Keshillit të Ministrave, “Për shpalljen e kompleksit ligatinior të Butrintit “Park Kombëtar”.

Me këtë VKM janë saktësuar kufijtë e parkut kombëtar të Butrintit, sipërfaqet e përdorimit të territorit...; ndryshohet pika 4 në lidhje me zonimin e territorit dhe pika 6 ndryshohet si më poshtë: Ngarkohen zyra e administrimit dhe koordinimit të PK të Butrintit, në varësi të MTKRS, administrata e PK, në varësi të MMPAU dhe Komiteti i Menaxhimit të këtij parku, në bashkëpunim me institucionet e specializuara, të realizojnë menaxhimin e parkut dhe të kontrollojnë zbatimin e planit të menaxhimit të PK.

Shtohet pika 5.1, kundër të tjera theksohet që MMPAU, MTKRS dhe ministritë e tjera të linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore të rishikojnë lejet që kanë dhënë për veprimtari ekonomike e shoqërore brendasi përfaqes së PK Butrint.

AKZM me strukturat e saj të vartësisë, ka detyrë dhe duhet të jetë e kujdesshme që të evidentojnë dhe të marrin masa për kremtimin me dinjitet të këtyre datave historike, duke hapur një faqe të re në punën e tyre, për njohjen dhe promovimin e zonave të mbrojtura, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet dhe shoqërinë civile.

INCA është e gatshme që të ndihmojë për promovimin e vlerave të natyrës e të biodiversitetit, në ngritjen e kapaciteteve për përmirësimin e menaxhimit të rrjetit të zonave të mbrojtura dhe në hartimin e historisë së zonave të mbrojtura të Shqipërisë.

Promovohet marka “Pelikani Miqsor”

Divjakë, 25 Janar 2017 - Në kuadër të Programit Noé Conservation, për “Menaxhimi i ligatinave dhe ruajtja e pelikanit kaçurrel në pellgun e Mesdheut”, në ambientet e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta, u promovua marka “Pelikani Miqsor”.



Në prezantim merrnin pjesë përfaqësues të komunitetit të peshkatarëve, të grave, mësues të shkollave publike, fermerë të zonës, biznesi lokal si dhe përfaqësues të AdRZM Fier.

Natyrë për të ardhmen - bashkëpunim i fuqishëm për zonat e mbrojtura

Tiranë 25 Janar 2017 - Projekti pesëvjeçar “Mbështetje institucionale për menaxhimin e zonave të mbrojtura në Shqipëri” ka ardhur në fundin e tij, duke kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në progresin e bërë në fushën e mbrojtjes së natyrës në Shqipëri. Projekti - i zbatuar nga Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit (MM) dhe Agjencia Kombëtare për Zonat e Mbrojtura (AKZM), i financuar nga Agjencia Italiane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (AICS) - ndihmoi në formimin e një kuadri të ri kombëtar institucional për zonat e mbrojtura, në iniciimin e ndryshimeve legislative dhe forcimin e menaxhimit të zonave të mbrojtura me efektivitet. “Ne kemi bërë një punë e madhe deri më tani në forcimin e sistemit të zonave të mbrojtura të Shqipërisë, dhe partneriteti ynë me MM, IUCN dhe AICS ishte i rëndësishëm në këtë drejtim”, tha Z. Zamir Dedej, Drejtor i Agjencisë Kombëtare për Zonat e Mbrojtura të Shqipërisë. “Ne do të vazhdojmë të ndërtojmë sinergji dhe të eksplorojmë potencialin e gjenerimit të të ardhurave të zonave të mbrojtura, pa kompromentuar ruajtjen e tyre”, përfundoi ai. Projekti ishte i rëndësishëm në forcimin e politikave për zonat e mbrojtura përmes integritetit të standardeve ndërkombëtare në proceset e planifikimit dhe

menaxhimit të zonave të mbrojtura. Dy zona pilote, Peisazhi i Mbrojtur i Lumit Buna dhe Territor-eve Ligatinore përreth tij dhe Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë (PK) janë përzgjedhur për rëndësinë e shërbimeve të ekosistemit që ato ofrojnë për komunitetet lokale. Planet e tyre të menaxhimit janë hartuar dhe përpunuar sipas Udhëzimeve për Planifikimin e Menaxhimit të IUCN ECPA (Komisioni Botëror mbi Zonat e Mbrojtura), përmes proceseve të konsultimit ku për herë të parë në Shqipëri ka pasur një shkallë kaq të gjerë pjesëmarrjeje aktive të aktorëve lokale. “Autoritetet kanë nevojë për shumë mbështetje që të arrijnë të sigurojnë krijimin dhe menaxhimin e sistemit kombëtar të zonave të mbrojtura, të sigurojnë krijimin dhe menaxhimin e sistemit kombëtar të zonave të mbrojtura. Ajo që kemi parë gjatë pesë viteve të fundit është një hap i madh përpara në përmirësimin e kuadrit institucional dhe menaxhimit me efektivitet të zonave të mbrojtura në Shqipëri. IUCN mbetet e angazhuar për ofrimin e këshillave të nevojshme për autoritetet dhe komunitetet për të shfrytëzuar potencialin e plotë të sistemit të zonave të mbrojtura të Shqipërisë”, tha z Boris Erg, Drejtor i Zyrës Rajonale IUCN për Europën Lindore dhe Azinë Qendrore. Disa nga kontributet më të dukshme të

Vijon në faqe 4

Vijon nga faqe 3 projektit në menaxhimin e zonave të mbrojtura në Shqipëri janë: - Procedura e standardizuar për planifikimin e menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe dy plane menaxhimi të përgatitura në përputhje të plotë me standartet ndërkombëtare për zonat e mbrojtura - Rinovimi i faciliteteve të zonave të mbrojtura dhe hapja e dy qendrave për vizitorët, si dhe ndërtimi i infrastrukturës së vizitorëve dhe ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe çiklizmit për të çuar përpara zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në zonat e mbrojtura, - Sigurimi i instrumenteve dhe metodologjive për planifikimin e menaxhimit dhe monitorimit në zonat e mbrojtura dhe një bazë të dhënash kombëtare të biodiversitetit (BioNNA) për të lehtësuar punën e autoriteteve, - Disa fushata ndërgjegjësimi dhe programe arsimore që synojnë për të ngritur njohuritë e komuniteteve lokale mbi parqet dhe vlerat e tyre, - Aplikimi Online për zonat e mbrojtura në Shqipëri, nisur si një mjet i rëndësishëm promovues, me të dhënat e për të dy zonat pilote të projektit. Italia tradicionalisht e sheh Shqipërinë si një partner të vlefshëm në rajon, dhe do të vazhdojë të mbështesë zhvillimin e saj të qëndrueshëm. Përmes projektit NatyrAL, si dhe përmes iniciativave të tjera të reja, ne do të cojme më tej arritjet dhe do të zgjerojmë punën tonë tashmë në dhjetë zona të mbrojtura, ndërsa hedhim bazat për ngritjen e rrjetit kombëtar Natura2000“, tha Z. Nino Merola, Drejtor i Agjencisë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim në Shqipëri.

Informacion rreth projektit

Titulli: Mbështetja institucionale për menaxhimin e zonave të mbrojtura në Shqipëri. Shqipëria është një vend i pasur me diversitet biologjik dhe mbi një e treta e territorit të saj është e mbuluar me pyjet-vendbanimi i ujërve, arinjve, rrëqebullit, derri të egër dhe shumë llojeve të tjera të faunës së eger.

Megjithatë rrethuar nga pasuritë natyrore, shumë njerëz në Shqipëri luftojnë për të bërë me

te mirën për të veten e tyre. Një nga planet tashmë të mire avancuara është shfrytëzimi i parqeve kombëtare të vendit dhe zonave të tjera të mbrojtura në mbeshtetje të nevojave të popullsisë, si dhe të vete natyrës. Bashkëpunimi Italian për Zhvillim është duke bashkëpunuar me Unionin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) për të promovuar qasje të reja për menaxhimin e zonave të mbrojtura, për të treguar një gamë të gjerë të përfitimeve që komunitetet lokale dhe më gjerë do të mund të gëzojnë nga ekosistemet e mire ruajtura dhe mirë-funksionale. Projekti ka për



qëllim të përfshijë në mënyrë aktive popullsinë lokale dhe influencimin e tyre në të ardhmen zonave të mbrojtura të Velipojës dhe Shebenik-Jabllanicës, të trajnoje zyrtaret në menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe të rrisë ndërgjegjësimin për të ndihmuar qeveritë lokale dhe kombëtare për të

shfrytëzuar më mirë potencialin natyror të këtyre zonave. Aktivitetet janë të mbështetura nga dy anëtarët e IUCN në Shqipëri: Instituti për Ruajtjen e Natyrës të Shqipërisë (INCA) dhe Shoqata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA).

Website i projektit: www.iucn.org/projectalbania
Broshura “Për një të ardhme të qëndrueshme”
https://www.iucn.org/sites/dev/files/import/downloads/albania_brochure_eng_31_05_2012_web_1.pdf

Rreth Agjencisë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS)

Në njëzet vitet e fundit, Shqipëria ka ndërmarrë një rrugë të rëndësishëm drejt stabilitetit politik dhe ekonomik, konsolidimin e institucioneve demokratike dhe rritje progresive ekonomike. Bazuar në këtë zhvillim politik dhe ekonomik, Kooperacioni Italian ka riformuluar programin e saj, duke synuar në këtë mënyrë kryesisht të mbështesë procesin e integritetit të Shqipërisë në BE si dhe identifikimin e prioriteteve dhe strategjive për miratimin dhe zbatimin e *acquis communautaire*, sikurse

Vijon në faqe 5

Vijon nga faqe 4 thuhet në Protokollin e Ri të bashkëpunimit dhe Zhvillimit Italo-Shqiptarë, 2014-2016. Për të nxitur zhvillimin social dhe ekonomik, Italia miraton një qasje multi-sektorial, zbatimin e projekteve që prekin disa fusha të ndërhyrjes. Bashkëpunimi italian aplikon si marevshjet dypalshe ashtu edhe ato shume palshe, mbështet në të njëjtën kohë projektet e OJQ-ve dhe bashkëpunimin e decentralizuar. Agjencia italiane për Bashkëpunimin dhe Zhvillim (AICS) siguron koordinimin e përgjithshëm, menaxhimin, monitorimin dhe raportimin e projektit. Ofron mbështetje teknike për aktivitetet dhe promovon koordinimin dhe sinergjitë me partnerët institucionalë dhe ndërkombëtarë shqiptarë në këtë fushë.

www.italcoopalbania.org

Rreth IUCN

IUCN është një Union anëtarësimi unike i përbërë si nga organizata qeveritare ashtu edhe ato të shoqërisë civile. Ajo ofron i organizatave publike, private dhe jo-qeveritare njohuritë dhe mjetet që mundësojnë në të njëjtën kohë progresin njerezor, zhvillimin ekonomik dhe mbrojtjen e natyrës. Krijuar në vitin 1948, IUCN tani është rrjeti mjedisor më i madh dhe më i shumellojshëm

ne bote botë, i cili mbledh njohuritë burimet, burimet e 1300 organizatave anëtare dhe 15.000 ekspertë. Ai është një ofruer kryesor i të dhënave të ruajtjes, vlerësimit dhe analiza. Anëtarësimi i saj i gjerë mundëson IUCN për të mbushur rolin e inkubatorit dhe besuar e praktikave më të mira, mjetet dhe standardet ndërkombëtare. IUCN ofron një hapësirë neutrale ku aktorë të ndryshëm, duke përfshirë qeveritë, OJQ-të, shkencëtarët, bizneset, ko-munitetet lokale, organizatat popujve indigjenë dhe të tjerët mund të punojnë së bashku për të krijuar dhe zbatuar zgjidhje për sfidat e mjedisit dhe për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm. Duke punuar me shumë partnerë dhe përkrahës, IUCN zbaton një portofol të madh dhe të ndryshme të projekteve të konservimit në të gjithë botën. Duke kombinuar shkencën e fundit me njohuritë tradicionale të komuniteteve lokale, këto projekte të punojnë për të rikthyer humbjen e habitatit, rivendosjen e ekosistemeve dhe për të përmirësuar mirëqenien e njerëzve. Si një partner i projektit të Natyrës IUCN ofron mbështetje teknike në lidhje me zonat e mbrojtura, ngritjen e kapaciteteve, shikimit dhe komunikimit.

Ftesë drejtuar gazetarëve që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në qytetet Shkodër, Tiranë, Elbasan, Berat dhe Vlorë / nga Qendra EDEN

Duke e vlerësuar rolin e medias vizive dhe të shkruar si një prej faktorëve kryesorë në rritjen e transparencës dhe angazhimit të qytetarëve në proceset vendimmarrëse, ftohen gazetarët që punojnë në qytetet Shkodër, Tiranë, Elbasan, Berat dhe Vlorë të jenë pjesë e trajnimit njëditor, i cili synon të ndikojë në rritjen e kapaciteteve të pjesëmarrësve për të qënë të përfshirë në debatë, konsultime dhe raportime mbi tematika thelbësore që lidhen në mënyrë të drejtë për drejtë me qytetarin dhe mjedisin.

Kjo përjasje bazohet në nevojën për të forcuar rolin dhe ndikimin e publikut, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë të interesuar në proceset vendimmarrëse të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis/Vlerësimit Strategjik në Mjedis, si edhe në reflektimin e çdo zhvillimi social apo politik që ndikon në mbarëvajtjen e procesit.

Nëpërmjet kësaj nisme gazetarët mund të:

- zhvillojnë më tej njohuritë e tyre për procedurat mbi VSM/VNM;

- të jenë më të informuar mbi tematika mjedisore;
- ndikojnë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe rolit të publikut për çështjet mjedisore;
- angazhohen dhe të forcojnë bashkëpunimin në nivel lokal me organizatat mjedisore.
- fokusojnë mjedisin në agendën mediatike si një aspekt i rëndësishëm i zhvillimit të qëndrueshëm.

Kjo ftesë vjen në zhvillim të projektit "Shoqëri pjesëmarrëse në vendimmarrje" mbështetur nga: Bashkimi Evropian, në kuadër të programit të grantit "Shoqëria Civile Vepron për Zhvillimin Social Ekonomik mbi Bazat e një Mjedis të Shëndetshëm (CO-SEED)", nëpërmjet INCA (Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri). Ju lutem dërgoni emrin e personit dhe gazetën/median që mbulon (nëse ka të tillë) brenda datës 20 shkurt 2017.

Për çdo informacion plotësues mos hezitoni të kontaktoni organizatën zbatuese

Vijon në faqe 6

Vijon nga faqe 5 të projektit në nivel lokal:

Qendra mjedisore për Zhvillim Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN) - Tiranë:
Herda Paço herda.paco@eden-al.org

Klubi Ekologjik Elbasan (KEE): Ahmet Mehmeti
ahmeteccel@hotmail.com

Qendra e Infomacionit Aarhus Shkodër (AIC):
aicshkodra@gmail.com

Qendra për Kërkim Bashkëpunim dhe Zhvillim:
(CRCD)- Vlorë: Alba Naçi info@crcd.org.al

Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore (FSEW)-
Berat: natyraberat@yahoo.com

Më shumë rreth projektit “Shoqëri
pjesëmarrëse në vendimmarrje”:

<http://bit.ly/2gBtndw>



Mëshfteknat e Shishtaveçit pjesë e Parkut Natyror Korab-Korçënik © Foto INCA

NJOFTIME

02 Shkurt - Dita Botërore e Ligatinave

04 Shkurt - Dita e themelimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM)

1 - Congress on ecological status and valuation of European lowland lakes - from 8 to 10th February 2017 at La Maison du Lac de Grand-Lieu at Bouaye (France). For more detailed information please visit the congress webpage: www.maisondulacdegrandlieu.com/european-congress

2 - Për të lexuar “Ditari i Natyrës” në vite... / <http://www.inca-al.org/index.php/sq/publikimet/ditari-i-natyrës>

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

• Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në ditarin e tij elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme. Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme. Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

Botim i Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA
Redaksia: Nihat Dragoti; Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Marinela Mitro

Rr. Islam Alla, Pall IVEA, Kati I, 1001, Tiranë; Tel/Fax: + 355 4 2231 437
www.inca-al.org; info@inca-al.org; www.facebook.com/inca.albania